

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE

LËNDA: HISTORI

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

1. Për 20 pyetjet me zgjedhje (alternativa), pasi të keni qarkuar alternativën e saktë në test, duhet të mbushni rrathët përkatës të tabelës në fletë përgjigje.

Lexoni me kujdes udhëzimet e dhëna në fletë përgjigje.

2. Për pyetjet me zhvillim përgjigjet duhet të shkruhen brenda zonës së kufizuar me vijë.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	4	5	10	17	18	19	27
Pikët							
Kërkesa	28	29	30	31	32	33	34
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Cila nga alternativat e mëposhtme është karakteristike për Spartën? **1 pikë**

- A) Ishte i vetmi qytet-shtet në Greqinë e Lashtë ku gratë mund të votonin.
- B) I kushtoi rëndësi të madhe filozofisë dhe letërsisë.
- C) Ishte një shtet i fuqishëm ushtarakisht.
- D) Synonte të zhvillonte demokracinë.

2. Si quheshin dy shtresat kryesore të popullsisë në Romën e Lashtë? **1 pikë**

- A) Plebejtë dhe patricët.
- B) Patricët dhe skllëvërit.
- C) Skllëvërit dhe plebenjtë.
- D) Demosi dhe plebejtë.

3. Rreth liqenit të Ohrit dhe Prespës shtrihej fisi ilir i: **1 pikë**

- A) amantëve;
- B) enkelejdëve;
- C) ardianëve;
- D) taulantëve.

4. Epoka e ndritur e demokracisë athinase lidhet drejtpërdrejt me emrin e Perikliut. Ai kreu një sërë reformash, që e çuan demokracinë në përsosmërinë më të lartë të kohës. Por pavarësisht të gjithave, demokracia athinase ishte ende e kufizuar.

Jepni dy argumente që tregojnë se demokracia në Athinë gjatë qeverisjes së Perikliut ishte e kufizuar. **2 pikë**

5. Identifikoni dy prej ndryshimeve që solli vendosja e pushtimit romak në Iliri. **2 pikë**

6. Cila prej principatave të mëposhtme të periudhës mesjetare kishte si kryeqendër Krujën? **1 pikë**

- A) Principata e Balshajve.
- B) Principata e Arianitëve.
- C) Principata e Arbrit.
- D) Principata e Topiajve.

7. Cili nga zhvillimet e mëposhtme lidhet me fillimet e Perandorisë Bizantine? **1 pikë**

- A) Lindja e kishës ortodokse ruse.
- B) Ndarja e Perandorisë Romake.
- C) Ardhja në pushtet e Justinianit.
- D) Rënia e Kostandinopojës.

8. Cili nga dukët e Normandisë arriti të pushtonte territoret angleze dhe të merrte titullin "Mbret i Anglisë"? **1 pikë**

- A) Uilliami I
- B) Henri I
- C) Eduardi I
- D) Henri II

9. Në shekullin XI shqiptarët njiheshin me emrin: **1 pikë**

- A) ilir;
- B) protoilir;
- C) arbër;
- D) shqiptarë.

10. Magna Karta (Karta e Madhe e Lirive) ishte një nga aktet më të mëdha në historinë e njerëzimit. Shpjegoni dy nga parimet e Magna Kartës. **2 pikë**

11. Çila nga ngjarjet e mëposhtme ndodhi në Gjermani në vitin 1834? **1 pikë**

- A) Emërimi i Bismarkut kancelar.
- B) Bashkimi doganor i njohur si "Zollverein"
- C) Lufta me Austrinë
- D) Kurorëzimi i Vilhelmit I Perandor i Perandorisë së Dytë Gjermane.

12. Pikëpamjet e Martin Luterit çuan në lindjen e: **1 pikë**

- A) judaizmit;
- B) katolicizmit;
- C) kristianizmit;
- D) protestantizmit.

13. Revolucioni amerikan filloi si një konflikt i hapur midis 13 kolonive të Amerikës së Veriut dhe: **1 pikë**

- A) Britanisë së Madhe;
- B) Portugalisë;
- C) Francës;
- D) Spanjës.

14. U krijua në Shqipërinë e Veriut, me qendër Shkodrën: **1 pikë**

- A) Principata e Topiajve;
- B) Principata e Balshajve;
- C) Principata e Muzakajve;
- D) Principata e Zenebishëve.

15. Në cilën nga mbledhjet e mëposhtme u shqyrtua çështja e alfabetit të gjuhës shqipe?

1 pikë

- A) Në Kongresin e Elbasanit.
- B) Në Kongresin e Manastirit.
- C) Në Kuvendin e Greçës.
- D) Në Kuvendin e Vlorës.

16. Rol të rëndësishëm në ruajtjen e pavarësisë së Shqipërisë në Konferencën e Paqes, luajti qëndrimi i vendosur i:

1 pikë

- A) Zhorzh Klemanso;
- B) Vitorio Orlando;
- C) Lloyd Xhorxh;
- D) Udro Uillson.

17.

a) Identifikoni një nga motivet që favorizuan zbulimet e mëdha gjeografike.

1 pikë

b) Cilat ishin dy nga pasojat negative të zbulimeve të mëdha gjeografike për Amerikën Latine?

2 pikë

18. Shpjegoni tre nga parimet bazë të qeverisjes që sanksionohen në kushtetutën amerikane.

3 pikë

Federalizmi:

Ndarja e pushteteve:

Kontrolli dhe baraspeshimi:

19. Luftërat e Skënderbeut kundër Perandorisë Osmane, pas krijimit të Lidhjes së Lezhës, provuan se kjo e fundit ishte një aleancë e brishtë. Për këtë arsye ai e çoi Lidhjen drejt një shteti të përqendruar.

Jepni tri nga arsyet pse Skënderbeu e çoi Lidhjen drejt një shteti të përqendruar.

3 pikë

20. Në statutin themeltar të Republikës së Shqipërisë së vitit 1925, presidenti ishte njëkohësisht kryetar i forcave të armatosura dhe kryeministër i vendit. Në këtë mënyrë forcohej më shumë pushteti:

1 pikë

- A) legjislativ;
- B) ekzekutiv;
- C) gjyqësor;
- D) vendor.

21. Në cilin nga shtetet e Bllokut Lindor u krijua "Solidarnost", një sindikatë e pavaruar që përbëhej nga punëtorë dhe intelektualë

1 pikë

- A) Çekosllovakia.
- B) Hungari.
- C) Poloni.
- D) RDGJ.

22. Një nga tiparet e diktaturave totalitare të majta ishte:

1 pikë

- A) ruajtja e pronës private;
- B) ekzistenca e dy partive kryesore;
- C) monopolizimi i pushtetit nga udhëheqësi;
- D) respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut.

23. Një nga pasojat e krizës ekonomike të viteve 1929-1933 në SHBA ishte:

1 pikë

- A) rimëkëmbja ekonomike e Evropës;
- B) rënia e bursës së Nju Jorkut;
- C) rritja e çmimit të aksioneve;
- D) humbja e vendeve të punës.

24. "Bashkimi i Kosovës me Shqipërinë", ishte pjesë e programit politik të:

1 pikë

- A) Lëvizjes së Legalitetit;
- B) Partisë Komuniste;
- C) Partisë Fashiste;
- D) Ballit Kombëtar.

25. Ndalimi i pronës private u vendos në kushtetutën e vitit:

1 pikë

- A) 1914
- B) 1922
- C) 1946
- D) 1976

26. Rendi në rend kronologjik shkëputjen e marrëdhënieve diplomatike/ekonomike të Shqipërisë me vendet e mëposhtme.

1 pikë

- A) Jugosllavi, BS, Kinë.
- B) BS, Kinë, Jugosllavi.
- C) Kinë, Jugosllavi, BS.
- D) Jugosllavi, Kinë, BS.

27. Më 29 korrik 1913 u mor vendimi sipas të cilit, Shqipëria vendosej nën kontrollin e Fuqive të Mëdha. Ky kontroll do të realizohej nëpërmjet Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit.

a) Cilat ishin dy kompetencat, që Komisionit Ndërkombëtar i Kontrollit do të ushtronte në Shqipëri?

2 pikë

28. Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, u organizua në Paris Konferenca e Paqes, ku morën pjesë shtetet fituese. Këshilli i të Katërtëve, që kishte fuqi vendimmarrëse, përbëhej nga: Britania e Madhe, SHBA, Franca dhe Italia.

a) Ku u nënshkrua marrëveshja e paqes me Gjermaninë në kuadër të kësaj konference?

1 pikë

b) Shpjegoni qëndrimin e dy prej shteteve fituese kundrejt Gjermanisë.

2 pikë

29. Në vitet '30 të shek. XX Shqipëria u përpoq të afrohej me vendet e tjera të Ballkanit dhe mori pjesë në disa konferenca ballkanike.

a) Pse u mor kjo iniciativë nga ana e Shqipërisë, pikërisht në këtë moment?

1 pikë

b) A ishte kjo një përpjekje e suksesshme? Shpjegoni përgjigjen tuaj.

2 pikë

30. Nga shumë kandidatura për të drejtuar Shqipërinë, Fuqitë e Mëdha zgjodhën gjermanin Vilhelm Vidi. Princ Vidi qeverisi në Shqipëri nga marsi deri në shtator të vitit 1914. Cilat ishin tri nga vështirësitë që hasi ai gjatë qeverisjes së tij në Shqipëri?

3 pikë

31. Evropa në shekullin XX përjetoi modele të ndryshme qeverisëse, një nga të cilat ishte ai i mbështetur mbi ideologjinë komuniste. Jepni tri tipare të këtij modeli qeverisës.

3 pikë

32. Lindja dhe përhapja e fashizmit në Itali lidhet me disa faktorë të aspektit politik, ekonomik dhe shoqëror. Jepni nga një faktor që ndikoi në lindjen e fashizmit në Itali për secilin nga aspektet. **3 pikë**

Politik

Ekonomik

Shoqëror

33. Margaret Theçer, pasi u bë kryeministre e Anglisë, ishte shumë e vendosur për reformat që do të ndërmernte. Për këtë arsye ajo u quajt "Zonja e hekurt".

a) Evidentoni tre prej masave që mori Margaret Theçer në zbatim të programit të saj ekonomik. **3 pikë**

b) Pavarësisht se politikat e Theçerit sollën rezultate pozitive, ato përsëri u kundërshtuan nga një pjesë e popullsisë. Identifikoni një nga arsyet pse u kundërshtuan reformat e saj. **1 pikë**

34. Gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, dy superfuqitë luftuan për të krijuar epërsi ndaj njëra – tjetrës. Analizoni se si u shpreh konfrontimi midis tyre në aspektin ushtarak dhe atë politik. **4 pikë**

Në aspektin ushtarak:

Në aspektin politik:
